



USAID ndihmon të rinjtë të punësohen

Mark Wood, drejtor i Programit për Ndërmarrje Private në Kosovë, në kuadër USAID-it, ka theksuar se ky institucion e konsideron **zhvillimin e fuqisë punëtore** si strategji kryesore në **përmirësimin e pozitës konkurruese** kompanive dhe sektorëve të Kosovës

Petrit Sherifi

PRISHTINË → Mbështetja e USAID-it, ofruar për trajnimin dhe programet e praktikës për studentët e Universitetit, ka rezultuar në punësimin profesional të 75 të rinjve.

Mark Wood, drejtor i Programit për Ndërmarrje Private në Kosovë, në kuadër të USAID-it, ka theksuar se ky institucion e konsideron zhvillimin e fuqisë punëtore si strategji kryesore në përmirësimin e pozitës konkurruese të kompanive dhe sektorëve të Kosovës.

"Pasi që e gjithë ekonomia e Kosovës po lëviz drejt shekullit 21, konkurrenca në treg, zhvillimi i shkathtësive për pjesëmarrësit aktualë dhe të ardhshëm të fuqisë punëtore dhe qasja e studentëve dhe e të papunëve në vende pune e profesione të

PROJEKTI

Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë i USAID-it është një nismë katërvjeçare e filluar në tetor 2008 dhe synon stimulimin e aftësisë konkurruese të sektorit privat në ekonomi e Kosovës.

reja, do të jetë kërkesë thelbësore. Për t'i ofruar studentëve, të papunëve dhe të punësuarve aktualë shkathtësitetë të cilat i përshtaten më mirë biznesit, Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë ka organizuar disa programe të praktikës", tha Wood.

Trajnim i dhe programi i praktikës në kontabilitet dhe financa, i implementuar nga Shoqata për Shërbime Financiare dhe Kontabilitetit (AFAS), ka

inkuadruar 103 studentë të ekonomisë.

Këta studentë kanë ndjekur programin e trajnimit dhe u vendosën si praktikantë nëpër banka dhe institucione mikrofinanciare. Deri më sot, 59 studentëve u janë vazhduar kontratat.

Nga programi i praktikës për fusha të ndryshme, i implementuar nga World University Service – Austria (WUS – Austria), përfituan 40 studentë. Këta studentë u vendosën në ministri dhe drejtori të ndryshme komunale të pesë komunave. Deri më tani, 2 prej tyre u është ofruar mundësi punësimi permanent.

Programi i praktikës për sektorin e prodhimeve të qumëshit, i implementuar nga Nisma për Zhvillim të Bujqësisë së Kosovës (IADK), ka inkuadruar 15 praktikantë: 10 studentë filletarë dhe 5 mentorë, të cilët ishin

zgjedhur nga piloti programit të vitit 2009. Prapë déshmoi të jetë suksesshëm për shkak he cilësia e qumështit huar nga fermerët, që ashtu pjesë e programit përmirësuar, si dhe i praktikës për industri për punimit të drurit, i implementuar nga Shoqata e Përgjegjësive Drurit të Kosovës (SADK), angazhoi 16 studentë të rinj të teknologjisë së Aplicave Aplikacione Shkencave Aplikacione Shkollë Profesionale Zdrukthëtarisë dhe Qendrave Aftësim Profesional, klientë të KPEP-it.

Ky projekt ishte shumë suksesshëm për shkak se 100% të studentëve u është ofruar punësimi kompanitë, ku ishin të cilët për praktikë. Deri më sot, 20 prej tyre i kanë pranuar ofertat e punës.